



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Runway" Sh.P.K. të datës 10.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-26-1564-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Runway" Sh.P.K. të datës 10.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-26-1564-1-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Runway" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-26-1564-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Pretendimi 1 Operatori ekonomik pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), duke kufizuar konkurrencën dhe duke diskriminuar operatorët ekonomikë. Në mënyrë të kundërligjshme, AK ka përshtatur specifikimet teknike duke favorizuar një prodhues të caktuar, konkretisht prodhuesin 5.11, dhe duke eliminuar prodhuesit e tjerë nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo vihet në pah përmes kërkesave specifike si: përdorimi i zinxhirëve origjinal YKK, dhe përdorimi i butonave cilësorë PRYM. Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me produkte të një prodhuesi të vetëm dhe nuk lejojnë produkte ekuivalente, duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën. Operatori ekonomik ka paraqitur kërkesë për sqarime shtesë me datë 27.03.2026, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigje në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në LPP. Sipas nenit 53.4 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që menjëherë të shqyrtojë çdo kërkesë për sqarime për të vlerësuar nëse operatorët ekonomikë kanë nevojë për informata shtesë për përgatitjen e një tenderi të përgjegjshëm. Mosveprimi i AK-së përbën shkelje të këtij neni, si dhe të nenit 28 të LPP-së. Gjithashtu, në sqarimin e datës 27.03.2026 lidhur me xhaketen dimërore, është specifikuar: “Duhet të përdoren vetëm zinxhirë origjinal YKK dhe butona kualitativë PRYM, në mënyrë që zinxhiri të jetë i qëndrueshëm dhe butonat të mbeten të mbyllur edhe gjatë aktiviteteve shumë të vështira.” Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të, rishikojë specifikimet teknike, lejojë produkte ekuivalente, dhe sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, me qëllim të garantimit të konkurrencës së drejtë. Ne baze të nenit 24.4 AK do të shqyrtoj menjëherë kërkesën sipas paragrafit 24.3 të kësaj rregullore dhe do të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo. a. Nëse jo, AK do të informojë menjëherë përmes platformës OE në fjalë për mohim. b. Nëse po, AK do të ofrojë informatat shtesë menjëherë përmes platformës, por nuk do të bëjë të ditur burimin e kërkesës së tillë. Pretendimi 2 45.10 Në rast se një Operator ekonomik, ka nevojë për informata sqaruese ose shtesë në elemente të caktuara të dosjes së tenderit, një kërkesë për informacion të tillë nëpërmjet platformës elektronike duhet të dorëzohet të autoriteti kontraktues brenda afatit të specifikuar në dosjen e tenderit në pajtim me nenin 53 të LPP. Një formular standard për një kërkesë të tillë është përfshirë në anekset për dosjen e tenderit, dhe e njëjta mund të përdoret nga OE. Ne si Operatori ekonomik vlerësojm se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka përbushur detyrimet ligjore për hartimin e specifikimeve teknike të qarta, të sakta dhe jo-diskriminuese, duke krijuar paqartësi serioze në përgatitjen e ofertës. Në përgjigjen e AK-së për artikullin “Xhaketa Dimërore”, janë kërkuar raporte testimi që duhet të përbushin standardet si në vijim: Testi i rezistencës ndaj depërtimit të ujit; Testi i rezistencës ndaj avujve të ujit; Testi i elasticitetit për xhaketen e jashtme; Testi i grisjes për xhaketen e jashtme; Testi i fuqisë së qepjes; Testi i analizës së fibrave për xhaketen e brendshme; Testi i stabilitetit dimensional ndaj larjes për xhaketen e brendshme; Testi i larjes për xhaketen e brendshme. Megjithatë, AK nuk ka specifikuar elemente thelbësore për këto kërkesa, duke krijuar paqartësi për operatorët ekonomikë. Për këtë arsye, kërkojmë sqarime si më poshtë. Cilat janë metodat standarde të testimit që duhet të përdoren për secilin nga testet e kërkuara (p.sh. ISO, EN apo standarde të tjera)? Për çfarë lloji larjeje kërkohet **testi i larjes për xhaketen e brendshme** (larje me dorë, larje në makinë, dhe në çfarë temperature)? Testi i fuqisë së qepjes a i referohet xhaketes së jashtme apo asaj të brendshme? Sa i përket artikullit “Pantallona dimërore”, janë evidentuar disa paqartësi dhe mospërputhje në specifikimet teknike: Në Aneksin 1, në figurën ilustruese, pantallonat paraqiten me pjesën e gjunjëve në ngjyrë të zezë, ndërsa në përshkrim kërkohet ngjyrë e kuqe. Kërkojmë sqarim nëse produkti final duhet të jetë, njëngjyrësh (vetëm i kuq), apo kombinim i ngjyrës së kuqe dhe të zezë sipas figurës. Nuk është përcaktuar gjerësia e shiritit reflektues (p.sh. 5 cm, 6 cm apo 7 cm), çka është element i rëndësishëm për përgatitjen e ofertës në përputhje me standardin UNI EN ISO 20471:2017. Kërkojmë sqarim nëse Deklarata e Konformitetit është e mjaftueshme për të dëshmuar përbushjen e standardeve të kërkuara, apo nëse kërkohen edhe raporte testimi nga laboratorë të akredituar. Mungesa e këtyre sqarimeve bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, pasi nuk siguron trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë, pamundëson përgatitjen e ofertave të krahasueshme dhe të përgjegjshme, krijon hapësirë për interpretim subjektiv gjatë vlerësimit të ofertave dhe kjo është bere qellimisht nga AK-ja. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të

hartojë specifitime të qarta dhe të plota, si dhe të japë sqarime të mjaftueshme për çdo paqartësi të ngritur nga operatorët ekonomikë. Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të saktësojë të gjitha kërkesat teknike dhe metodat e testimit, eliminojë paqartësitë në përshkrimin e produkteve, sigurojë kushte të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë si parashihet me ligj. Në të kundërtën, këto mangësi përbëjnë bazë për kontestim të mëtejshëm të kësaj procedure të prokurimit në OSHP.

Pretendimi 3 NE si Operatori ekonomik pretendojmë se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili garanton trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë në procedurat e prokurimit. Nga analiza e dokumentacionit të tenderit dhe specifikimeve teknike, rezulton se AK, ka hartuar specifitime teknike që favorizojnë një prodhues të caktuar, (p.sh. kërkesa për zinxhirë YKK dhe butona PRYM), duke përjashtuar operatorët e tjerë ekonomik që ofrojnë produkte ekuivalente. Nuk ka lejuar alternativa ekuivalente, duke kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ka krijuar paqartësi në specifitime teknike (mungesë e metodave të testimit, paqartësi në përshkrimin e produkteve), duke pamundësuar përgatitjen e ofertave të krahasueshme, nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesave për sqarime brenda afateve ligjore. Këto veprime të AK-s janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konkretisht: Prodhuesit -operatorët ekonomik nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese gjatë përpilimit të specifikimeve teknike, mënyra e hartimit të specifikimeve ka reduktuar dhe praktikisht eliminuar konkurrencën. Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë që favorizojnë një operator/prodhues të caktuar, pasi janë krijuar kushte që rezultojnë në diskriminim material ndërmjet operatorëve ekonomik, pasi kërkesat teknike në mënyrë indirekte detyrojnë përdorimin e produkteve nga prodhues të caktuar, pasi janë vendosur specifitime teknike diskriminuese dhe jo të qarta, të cilat nuk sigurojnë konkurrencë të hapur dhe transparente. Për më tepër, kërkesat si, përdorimi i markave specifike (YKK, PRYM), mungesa e përcaktimit të metodave të testimit; paqartësitë në përshkrimin e produkteve (ngjyra, dimensione, karakteristika teknike), janë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë në prokurim publik.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, konkretisht sa i përket pretendimit se AK nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën për sqarime, njoftojmë që të gjitha përgjigjet janë kthyer përkatësisht janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme ashtu që janë ngarkuar në eprokurim me datë 08.04.2026 respektivisht 2 ditë para se të parashtrohet kjo kërkesë për rishqyrtim e datës 10.04.2026. Sa i përket pretendimeve ankimore, është gjetur se të njëjtat janë të pabazuara dhe AK qëndron prapa sqarimeve të dhënave dhe kërkesave në DT. Me fjalë tjera të gjitha kërkesat në DT janë absolutisht të domosdoshme për garantuar efikasitetin dhe efektivitetin me rastin e ekzekutimit të kësaj kontrate.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specififikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësien kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specififikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.04.2026

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.